



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 77

Tiranë – E hënë, 23 maj 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 18.5.2022	Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022..... 10023
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 65, datë 11.4.2022	Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Blue 1”, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw..... 10025
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 78, datë 13.4.2022	Mbi rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020..... 10026



AKT NORMATIV
Nr. 10, datë 18.5.2022

**PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË
ÇMIMIT PËR DISA MATERIALE
NDËRTIMI, SIPAS PËRCAKTIMEVE NË
KONTRATAT PUBLIKE PËR PUNË, SI
PASOJË E SITUATËS SË VEÇANTË TË
KRIJUAR NË TREG GJATË VITIT 2022**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Ky akt normativ ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe kriterëve për kompensimin financiar të çmimit të hekurit, çimentos, bitumit, tubave plastikë, aluminit, bakrit dhe zinkut në kontratat publike për punë që plotësojnë kriteret e nenit 2, të këtij akti normativ, të lidhura në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe në kuadër të procesit të rindërtimit, si pasojë e situatës së veçantë, të krijuar në treg gjatë vitit 2022.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky akt normativ zbatohet për kontratat publike për punë, të financuara me fonde të buxhetit të shtetit, të njësive të qeverisjes qendrore dhe vendore, njësive zbatuese të caktuara në kuadër të procesit të rindërtimit apo të enteve të tjera publike të cilat janë në proces për t'u lidhur përpara hyrjes në fuqi të këtij akti normativ ose në proces zbatimi që nga data 1 janar 2020 dhe që preken nga rritja e çmimit të hekurit, çimentos, bitumit dhe tubave plastikë, për punë të kryera pas hyrjes në fuqi të këtij akti normativ.

2. Ky akt normativ zbatohet për kontratat publike për punë, të financuara me fonde të shoqërive me kapital shtetëror të paktën 51% apo me financim të huaj, që përballohen nga fondet e shoqërive me kapital shtetëror, të cilat janë në

proces për t'u lidhur përpara hyrjes në fuqi të këtij akti normativ ose në proces zbatimi që nga data 1 janar 2020 dhe që preken nga rritja e çmimit të hekurit, çimentos, bitumit, aluminit, bakrit dhe zinkut, për punë të kryera pas hyrjes në fuqi të këtij akti normativ.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllim të këtij akti normativ, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Autoritet kontraktor” është autoriteti i cili lidh një kontratë publike për punë të financuara nga buxheti i njësive të përcaktuara në nenin 2, të këtij akti normativ, si dhe autoriteti përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi, në kuadër të procesit të rindërtimit;

b) “Kontrata publike për punë” ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në legjislacionin për prokurimin publik;

c) “Kontrata shitesë” nënkupton kontratën mes autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, sipas procedurës së përcaktuar në këtë akt normativ, kur miratohet kompensimi.

Neni 4
Situata e veçantë

Situatë të veçantë, në kuptim të këtij akti normativ, përbëjnë të gjitha rastet të cilat krijojnë situatë emergjente si pasojë e rritjes së ndjeshme të çmimit të tregut për materialet e hekurit, çimentos, bitumit, tubave plastikë, aluminit, bakrit dhe zinkut, në krahasim me çmimet ekzistuese në momentin e lidhjes së kontratës publike për punë.

Neni 5
Kriteret dhe dokumentacioni për përfitimin e kompensimit

1. Me shpalljen e situatës së veçantë, sipas këtij akti normativ, operatorët ekonomikë, të angazhuar në kontrata publike për punë me fonde të buxhetit të shtetit, të njësive të qeverisjes qendrore dhe vendore, njësive zbatuese të caktuara në kuadër të procesit të rindërtimit ose të enteve të tjera publike apo të shoqërive me kapital shtetëror të paktën 51%, i paraqesin autoritetit kontraktor kërkesën për kompensim, sipas aneksit nr. 1, vetëm për pjesën e



kostos që lidhet me rritjen e çmimit të materialeve të ndërtimit, të përcaktuara në nenin 2, të këtij akti normativ.

2. Autoritetet kontraktore shqyrtojnë kërkesën sipas pikës 1, të këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Në rast të refuzimit të kërkesës, operatori ekonomik ka të drejtë të ankimojë vendimin në gjykatën kompetente.

3. Shtesa e kontratës hartohet në bazë të rritjes së çmimit në raport me vlerën e këtyre materialeve në kontratën publike për punë. Kjo shtesë duhet të jetë brenda kufirit të përcaktuar në nenin 6, të këtij akti normativ.

4. Autoritetet kontraktore paraqesin shtesat e kontratave të miratuara te ministritë e linjës/institucionet qendrore, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit për kontratat në kuadër të procesit të rindërtimit, bordet drejtuese, këshillat bashkiakë apo këshillat mbikëqyrës të shoqërive publike, të cilat parashikojnë burimet përkatëse për mbulimin e tyre.

5. Kompensimi i fondeve të parashikuara në kontratën shtesë bëhet nga autoriteti kontraktor pas verifikimit të gjendjes së punimeve të realizuara dhe faturës së blerjes së materialeve të ndërtimit, të përcaktuara në nenin 2, të këtij akti normativ, sipas parashikimeve të kontratës shtesë.

6. Me qëllim shmangien e abuzimit, strukturat shtetërore dhe autoritetet kontraktore mund të kryejnë edhe verifikime në vend, në rast konstatimi të pasaktësive në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëritë. Për kryerjen e verifikimeve autoritetet kontraktore mund të marrin edhe ekspertë sipas fushave përkatëse.

7. Pas verifikimit, sipas pikës 5, të këtij neni, kryhet pagesa për kompensimin sipas legjislacionit në fuqi.

8. Në rast të përfundimit të situatës së veçantë, fondi i papërdorur nga shtesa e kontratës mbetet në buxhetin e autoritetit kontraktor.

Neni 6

Masa e kompensimit të shtesës së kontratës

1. Kompensimi i secilit prej operatorëve ekonomikë që përmbushin kriteret e këtij akti normativ, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 2, të këtij akti normativ, bëhet në masën nga 5% deri në 30% të vlerës që zënë materialet e hekurit, bitumit, çimentos, tubave plastikë, aluminit, bakrit dhe

zinkut në kontratat publike respektive. Në çdo rast, vlera e kompensimit nuk tejkalon masën nga 5% deri në 30% të vlerës të materialeve të përmendura.

2. Shtesa e kontratës sipas kompensimit të materialeve sipas pikës 1, të këtij neni, nuk do të konsiderohet si shtesë kontrate, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe të procesit të rindërtimit.

3. Në rast se operatori ekonomik nuk bie dakord me vlerën e vendosur të kompensimit nga autoriteti kontraktor, kontrata ndërmjet palëve zgjidhet dhe rihapet një procedurë e re prokurimi për realizimin e punimeve të papërfunduara. Gjithashtu, ndaj operatorit ekonomik merret masa e përjashtimit nga procedurat e përfitimit të kontratave publike për një periudhë 3-vjeçare nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Neni 7

Kohëzgjatja dhe zbatimi

1. Parashikimet e këtij akti normativ zbatohen për atë kohë sa zgjat periudha e situatës së veçantë të krijuar në treg.

2. Hyrja në fuqi e këtij akti normativ konsiderohet edhe shpallje e situatës së veçantë.

3. Përfundimi i situatës së veçantë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit përgjegjës për infrastrukturën.

Neni 8

Dispozitë kalimtare

1. Për kontratat publike për punë, që do të lidhen pas hyrjes në fuqi të këtij akti normativ, autoritetet kontraktore duhet t'u referohen çmimeve të tregut për materialet e hekurit, çimentos, bitumit, tubave plastikë dhe në rastin e shoqërive me kapital shtetëror të paktën 51%, duke përfshirë edhe aluminit, bakrit dhe zinkun.

Në veçanti për procesin e rindërtimit, autoritetet kontraktore, për materialet e përcaktuara në këtë akt normativ, duhet t'u referohen çmimeve të tregut.

2. Vonesat në zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrihet efektet ky akt normativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në proces zbatimi nga data 1 janar 2020, nuk do të konsiderohen si



shkelje e kushteve kontraktore dhe nuk do të aplikohen penaltete ndaj operatorëve ekonomikë.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKS NR. 1

KËRKESË

Emri i operatorit ekonomik _____

NIPT-i: _____

Objekti i kontratës/projekti _____

Kërkesa për kompensim _____

***Bashkëlidhur kësaj kërkesë:**

- Vlera e parashikuar e punimeve për vitin 2022;
- Vlera e parashikuar për përdorimin e materialeve të ndërtimit sipas përcaktimeve të neneve 2 dhe 6, të këtij akti normativ për vitin 2022;
- Vlera e kërkuar për kompensim të parashikuar në kontratën shtesë;
- Shpjegime të tjera.

VENDIM
Nr. 65, datë 11.4.2022

MBI SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “BLUE 1”, ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të

ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 434/7 dhe 434/7-1 prot., datë 8.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw”,

konstatoi se:

Në vijim të relatimit në mbledhjen e Bordit të datës 11.4.2022, të relacionit të protokolluar me nr. 434/7 prot., datë 5.4.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw”, lindi nevoja për të sqaruar me shoqërinë çështjet që kanë të bëjnë me:

- fillimin e punimeve të centralit dhe çdo sqarim që lidhet me afatin e vlefshmërisë së licencës;
- financimin e ndërtimit të centralit dhe nënshkrimin/depozitimin e marrëveshjes së financimit;
- pajisjen me certifikatë pronësie për pasuritë me nr. 535/3, nr. 622 dhe nr. 537, për të cilat është bërë me dije se pagesa e kështit të fundit do të kryhet brenda muajit prill 2022.

Në të tilla rrethana, për të mundësuar sqarimin e sa më sipër, vlerësohet shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes përfundimtare të Bordit të ERE-s për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 78, datë 13.4.2022

**MBI RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR
TË BALANCIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN
NR. 106, DATË 2.7.2020**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 486 prot., datë 8.4.2022, të drejtorive teknike, “Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a. për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 21.12.2021,

konstatoi se:

- OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 5977/7 prot., datë 9.12.2021, ka sjellë propozimin në ERE “Mbi rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 255, datë 21.12.2021, “Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a., për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020”, ndër të tjera, vendosi si më poshtë vijon:

- Pranimin e pjesshëm të propozimit të shoqërisë OST sh.a., “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020.

- Fillimin e procedurës për rishikimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 89, datë 31.3.2021, “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 prill 2021”.

- Fillimin e procedurës për amendimin e “Rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, lidhur me garancitë financiare.

- OST sh.a. të paraqesë në ERE analizën përkatëse për llogaritjen e vlerës minimale të garancisë financiare prej 10 milionësh ALL.

- Zgjatjen e efekteve juridike të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 155, datë 30.6.2021, deri në datën 15 prill 2022.

- Në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2021, nëpërmjet shkresës nr. 1 prot., datë 5.1.2022, u realizua njoftimi i shoqërisë OST sh.a. mbi vendimmarrjen e ERE-s dhe me shkresën nr. 358 prot., datë 9.3.2022, ERE ka rikujtuar palët për të shprehur opinionet përkatëse lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 255/2021.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 255/2021 është publikuar në faqen zyrtare të ERE-s: www.ere.gov.al.

- Shoqata AREA, nëpërmjet shkresës nr. 1810/139 prot., datë 24.3.2022, midis të tjerash parashtron, se: “Në lidhje me propozimin e OST-së, ne mendojmë se vendosja e një kolaterali optimal është shumë e rëndësishme për sigurinë e operimit dhe jemi dakord në përgjithësi me vlerat”.

- Lidhur me sa parashtruar më sipër nga shoqata AREA, nëpërmjet shkresës nr. 1810/139 prot.,



datë 24.3.2022, vlerësojmë se janë dhënë mendime të përgjithshme mbi ecurinë e tregut të balancimit të energjisë elektrike për disa çështje që nuk janë pjesë e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, të shprehura nëpërmjet vendimit nr. 255/2021.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 255/2021, ka përcaktuar: “Fillimin e procedurës për rishikimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 89, datë 31.3.2021, ‘Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 prill 2021’”.

- Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 89, datë 31.3.2021, “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 prill 2021”, përcakton se: “Mekanizmi i garancisë financiare që OST sh.a. do të aplikojë për pjesëmarrësit në tregun e balancimit të jetë ai i përcaktuar në Rregullat e mekanizmit të përkohshëm të balancimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 193, datë 24.11.2017”.

- Fillimi i procedurës së shqyrtimit të propozimit të OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 5977/7 prot., datë 9.12.2021, të trajtuar nëpërmjet vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255/2021, lidhet me garancitë financiare të cilat janë duke u aplikuar në tregun e balancimit të energjisë elektrike. Për këtë pikë shoqata AREA në shkresën nr. 1810/139 prot., datë 24.3.2022, parashtrohet se: “Në lidhje me propozimin e OST-së, ne mendojmë se vendosja e një kolaterali optimal është shumë e rëndësishme për sigurinë e operimit dhe jemi dakord në përgjithësi me vlerat”.

- Nëse shoqata AREA gjykon se duhet të bëhen ndryshime të tjera në rregullat e Tregut të Balancimit të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106/2020, duhet të bëjë një kërkesë në ERE konform akteve ligjore në fuqi, ku të paraqesë argumentet mbi nevojën për ndryshime në rregullat e tregut të balancimit në fuqi dhe të cilat janë në zbatim që nga data 1 prill 2021.

- OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1413/2, datë 29.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 316/2 prot., datë 30.3.2022, ka dhënë sqarimet përkatëse për shoqatën AREA.

- Gjithashtu, në vijim të komunikimit, KESH sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1434 prot., datë 17.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 395, datë 23.3.2022, ka parashtuar në ERE, si më poshtë vijon: “Në përgjigje të propozimit të OST sh.a. bërë me shkresën nr. 5977/7, datë 9.12.2021, lidhur

me Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike dhe, veçanërisht, rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve të tregut, shprehemi parimisht dakord me propozimet dhe shpresojmë që një masë e tillë e propozuar nga OST sh.a. të ndikojë pozitivisht edhe në drejtim të shlyerjes në kohë të detyrimeve përkundrejt Ofruesve të Shërbimit të Balancimit, detyrime të cilat për KESH (në rolin e ofruesit të Shërbimit të Balancimit) janë kthyer në pengesë për ushtrimin e rregullt të aktivitetit tregtar, për më tepër në kushtet kur operojmë në tregun shqiptar të energjisë elektrike nën detyrimin për shërbimin publik”.

- Shoqëria FTL sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 757/1 prot., protokolluar në ERE me nr. 358/2 prot., datë 6.4.2022, parashtrohet, si më poshtë vijon: “Në vijim të shkresës tuaj nr. 358 prot., datë 9.3.2022, me lëndë: ‘Kujtesë për marrje mendimi për vendimin e ERE-s lidhur me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020’, bazuar në propozimet e OST sh.a., paraqitur me shkresat nr. 5977/7 prot., datë 9.12.2021 dhe nr. 1893 prot., datë 23.3.2022, shkresa të publikuara në faqen zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë, shprehemi se meqenëse OST sh.a. është në proces vlerësimi dhe rishikimi të plotë të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit, FTL sh.a./“OSHEE Group” sh.a., do të paraqesë mendimet/opinionet, pasi të njihet me paketën e ndryshimeve të Rregullave të Tregut të Balancimit”.

- Në pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2021, “Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a., për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020”, është vendosur, se: “OST sh.a. të paraqesë në ERE analizën përkatëse për llogaritjen e vlerës minimale të garancisë financiare prej 10 milionësh ALL”.

- Lidhur me sa kërkohet në këtë pikë të vendimit të ERE-s, OST sh.a., nëpërmjet komunikimit me *e-mail* të protokolluar në ERE me nr. 1/1, datë 20.1.2022, ka paraqitur disa llogaritje dhe tabela të përdorura për nxjerrjen e vlerës minimale të garancisë financiare prej 10 milionësh ALL.

- Vlerësojmë se OST sh.a. në zbatim të përcaktimeve të pikës 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255/2021, do të duhej të sillte një analizë të plotë për sa kërkuar dhe jo vetëm tabelën e vlerave të përdorura në analizë.



- Duke marre në konsideratë gjithë sa më sipër parashtruar, shoqëria OST sh.a., e cila ka bërë propozimet nëpërmjet shkresës nr. 5977/7 prot., datë 9.12.2021, për të cilën ka filluar procesi i shqyrtimit nëpërmjet vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255/2021, nëpërmjet shkresës nr. 1893 prot., datë 23.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 395/1, datë 24.3.2022, e cila është publikuar në faqen zyrtare të ERE-s, ka parashtruar, si më poshtë vijon: “Me shkresën nr. 5977/7 prot., datë 9.12.2021, OST sh.a., nisur nga situata e krijuar nga kriza energjetike në gjithë Evropën, e cila ka afektuar edhe Shqipërinë, kërkoi rishikimin e garancisë financiare konform akteve rregullatore në fuqi. Ndërkohë OST-ja po kryen analizën e implementimit të rregullave të mekanizmit të balancimit gjatë periudhës 1-vjeçare. Në këto kushte komiteti përgjegjës i ngritur për rishikimin e rregullave, i ndikuar veçanërisht edhe nga kushtet e krizës, po vlerëson të gjithë skenarët me qëllim që të kemi një rishikim të plotë dhe gjithëpërfshirës të rregullave pjesë përbërëse e të cilave është dhe garancia financiare. Për gjithë sa më sipër, OST-ja do të kërkonte mirëkuptimin tuaj, që propozimet, në lidhje me rishikimin e garancisë financiare të merren në shqyrtim nga ERE, pasi OST-ja të paraqesë paketën e ndryshimeve të rregullave të tregut shqiptar të balancimit (pjesë përbërëse e të cilave është dhe garancia financiare). Duke shpresuar se propozimi ynë do të merret në konsideratë prej jush, jemi të hapur për çdo sqarim të mëtejshëm”.

- Lidhur me sa parashtruar nga OST sh.a. në shkresën e sipërcituar vlerësojmë si më poshtë:

- Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106/2020, në pikën: 3.3.1 përcaktojnë, se: “Rregullat e TSHB mund të ndryshohen bazuar në shkaqe të argumentuara nga OST sh.a., ERE ose nga çdo pjesëmarrës tregu nëpërmjet një kërkesë të drejtuar OST sh.a., OST sh.a. do të krijojë një komitet përgjegjës për ndryshimin e rregullave, i cili mund të iniciojë ndryshimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit dhe OST sh.a. do t'i paraqesë zyrtarisht ERE-s ndryshimin e propozuar”.

- OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1893 prot., datë 23.3.2022, bën me dije, se: Komiteti përgjegjës i ngritur për rishikimin e rregullave, i ndikuar veçanërisht edhe nga kushtet e krizës, po vlerëson

të gjithë skenarët”, me qëllim që të kemi një rishikim të plotë dhe gjithëpërfshirës të rregullave pjesë përbërëse e të cilave është dhe garancia financiare.

- Ngritja e komitetit përgjegjës nga OST sh.a., me qëllim vlerësimin e çdo aspekti të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106/2020, është një element pozitiv dhe i krijon një mundësi të shtuar pjesëmarrësve të tregut të paraqesin në OST sh.a., si operuese e tregut të balancimit të energjisë elektrike eksperiencën dhe vlerësimet e tyre lidhur me përmirësimin nëse është e nevojshme të rregullave.

- Në këto rrethana për të krijuar një mundësi më të mirë për të gjithë pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike për të shprehur vlerësimet respektive në komitetin e ngritur nga OST sh.a. dhe për të pasur një harmonizim të ndryshimeve të rregullave të tregut të balancimit, pjesa e garancive financiare në shqyrtim të vlerësohet në vijim, me paraqitjen nga OST sh.a. të propozimit të referuar në shkresën nr. 1893 prot., datë 23.3. 2022.

- Në të njëjtën kohë në komitetin përgjegjës OST sh.a. duhet të paraqesë dhe të diskutojë me palët e interesit dhe analizën përkatëse për llogaritjen e vlerës minimale të garancisë financiare prej 10 milionësh ALL, analizë të cilën e ka sjellë të paplotë nëpërmjet komunikimit me *e-mail* në ERE.

- Për rrjedhojë, vlerësojmë të arsyeshme mbylljen e procedurës së nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2021, “Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a., për Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020”.

- Të gjitha propozimet e bëra nga palët e interesit, respektivisht shoqëria KESH sh.a. dhe shoqata AREA, në kuadër të procesit të konsultimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2021, të mbahen në konsideratë si nga OST sh.a. në komitetin respektiv, si dhe nga ERE në momentin e shqyrtimit të propozimeve që do të përcjellë OST sh.a., sikurse shprehet me shkresën nr. 1893 prot., datë 23.3. 2022.

- Në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE nr. 89, datë 31.3.2021, është vendosur, se: “Për periudhën deri në 30 qershor 2021, periudha kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet



dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore”.

- Sikurse evidentuar në pikën 3 të vendimit nr. 89/2021 është përcaktuar, se: “Periudha kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore”.

- Lidhur me këtë përcaktim, OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 1892 prot., datë 23.3.2022, protokolluar në ERE me numër 400, datë 24.3.2022, ka parashtruar, si më poshtë vijon:

- Në vijim të shkresës tonë nr. 5977/7 prot., datë 9.12.2021, ku në kushtet e shpalljes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, në zbatim të VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, OST ka qenë e detyruar të pezullojë investimet e parashikuara për vitin 2021, duke krijuar po ashtu dhe ngadalësim të procesit të implementimit në platformën elektronike DAMAS të specifikimeve që reflektojnë përmbushjen e parashikimeve të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020.

- Duke marrë në konsideratë dhe kohën e nevojshme të zhvillimit të procedurës për procesin e implementimit në platformën elektronike DAMAS, të gjitha specifikimeve të nevojshme konform rregullave në fuqi dhe të gjetura në kushtet e mosmiratimit të planit të investimeve për vitin 2022, OST vlerëson që nevojitet një periudhë më e gjatë për ta finalizuar këtë proces të rëndësishëm për operimin e tregut balancues.

- Për gjithë sa më sipër, OST kërkon mirëkuptimin tuaj për miratimin e zgjatjes së periudhës së parashikuar në pikën 5 të vendimit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2021 deri në datën 31 dhjetor 2022.

- Lidhur me sa parashtruar nga OST sh.a., për këtë pikë vlerësojmë, si më poshtë:

- OST sh.a. përgjatë periudhës kohore nga 1 prill 2021, momenti kur ka filluar operimi i tregut të balancimit të energjisë elektrike bazuar në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106/2020, nuk ka aplikuar rezolucionin 15-minutësh, si periudha kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave, por intervalin kohor prej 1 ore.

- Përgjatë kësaj periudhe kohore të operimit të tregut të balancimit të energjisë elektrike, në raportimet periodike të bëra nga OST sh.a. nuk është evidentuar problematikë në tregun e balancimit, e cila të lidhet me intervalin kohor prej 1 ore në të cilin realizohen proceset ku përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave në treg.

- Po ashtu, pjesëtarët e tjerë të tregut të energjisë elektrike, të cilët operojnë në tregun e balancimit nuk kanë përcjellë në ERE shqetësime apo problematika që lidhen me intervalin kohor prej 1 ore në të cilin realizohen proceset ku përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave në treg.

- Në të njëjtën kohë, si rrjedhojë e situatës së krijuar në sektorin e energjisë në tërësi, por edhe të energjisë elektrike në veçanti, mbështetur në nenin 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, vendosi: “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”.

- Pezullimi i planeve të investimeve të shoqërive publike me VKM-në nr. 584, datë 8.10.2021, ka si qëllim kryesor, krijimin e fondeve të nevojshme për të përballuar blerjen e energjisë elektrike me kosto të rritura, për garantimin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve.

- OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1892 prot., datë 23.3.2022 protokolluar në ERE me nr. 400 prot., datë 24.3.2022, ka evidentuar faktin se në kushtet e shpalljes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, në zbatim të VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, OST ka qenë e detyruar të pezullojë investimet e parashikuara për vitin 2021, duke krijuar po ashtu dhe ngadalësim të procesit të implementimit në platformën elektronike DAMAS të specifikimeve që reflektojnë përmbushjen e parashikimeve të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 106, datë 2.7.2020.

- Deklarimi i pamundësisë teknike nga OST sh.a., për shkak se nuk janë realizuar në platformën DAMAS specifikimet që mundësojnë aplikimin e rezolucionit 15-minutësh si periudha kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave do të



pamundësonte operimin e tregut të balancimit në këtë rezolucion kohor. Për rrjedhojë do të mbeteshin të paplotësuara detyrimet që burojnë nga ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, mbi rolin e OST-së në sigurimin e shërbimit të balancimit në treg.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 108, datë 22.4.2021, ka miratuar “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1), të komisionit rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”. Këto rregulla aplikohen nga OST-të e Evropës kontinentale anëtare të ENTSO-E, që nga data 1 qershor 2021. Aktualisht për OST sh.a. aplikimi i këtyre rregullave është duke u realizuar me intervalin kohor prej 1 ore. Në këtë kontekst aplikimi i intervalit kohor prej 1 ore në tregun e brendshëm të balancimit të energjisë elektrike nuk sjell asnjë pasojë për këtë mekanizëm.

- Duke marrë në konsideratë faktin se OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1893 prot., datë 23.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 395/1 prot., datë 24.3.2022, bën me dije, se: Komiteti përgjegjës i ngritur për rishikimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, po vlerëson të gjithë skenarët, me qëllim që të kemi një rishikim të plotë dhe gjithëpërfshirës të rregullave, pjesë përbërëse e të cilave mund të jetë dhe rishikimi i intervalit kohor prej 15 minutash në proceset e tregut të balancimit ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave, vlerësojmë si kohë të mjaftueshme për përgatitjen e këtyre ndryshimeve dhe përcjelljen në ERE për shqyrtim afatin kohor deri në 30 shtator 2022”.

- Në këto kushte është e nevojshme pranimi i pjesshëm i propozimeve të bëra nga OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1893 prot., datë 23.3. 2022, protokolluar në ERE me nr. 395/1 prot., datë

24.3.2022, dhe shkresës nr. 1892 prot., datë 23.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 400 prot., datë 24.3 2022. Ky element do të mundësonte, operimin e tregut të balancimit me intervalin kohor prej 1 ore në proceset e tregut të balancimit ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave e cila mbetet e vetmja mundësi për funksionimin e këtij tregu.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mbyllet e procedurës së nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2021, “Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a., për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020”.

2. Deri më 30 shtator 2022, perioda kohore e proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët përfshira, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë